

EDUKIMI PA DHUNË I FËMIJËVE DHE PRINDËRIMI POZITIV



PRINDËRIT LUAJNË ROLIN KRYESOR NË MIRËRRITJEN E SHËNDETSHME TË FËMIJËVE. ATA JANE MESUESIT, MODELET DHE UDHËRRËFYESIT MË TË RËNDËSISHËM PËR FËMIJËT E TYRE.

NDESHKIMI TRUPOR:

Është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim te fëmija, me qëllim për të korigjuar sjelljen e fëmijës. Ndëshkimi trupor bëhet nga prindërit, kujdestarët apo persona të tjerë përgjegjës për fëmijën. Ai përfshin: rrahjen, torturën, shkundjen, shtytjen, djegien, goditjen, pickimin, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, si dhe çdo veprim të ngjashme me këto.

DISIPLINA POZITIVE:

Disiplina positive synon t'u mësojë fëmijëve sjelljet e pranueshme, dhe ti edukojë ata, jo nëpërmjet ndëshkimit, por nëpërmjet respektit, besimit, ngrohtësisë dhe sigurisë emocionale.

PRINDËRIMI POZITIV:

Prindërimi pozitiv është një mënyrë e të rriturit dhe edukuarit të fëmijës që synon mirërritjen e shëndetshme të fëmijës. Prindërimi pozitiv e ndërton marrëdhënien prind-fëmijë bazuar mbi respektin reciprok dhe përdor disiplinën pozitive për edukimin e fëmijës.

Ka një sërë shkaqesh që i bëjnë prindërit Shqiptarë të përdorin ndëshkimin trupor për të disiplinuar fëmijët e tyre. Ndër to mund të përmendim:

- + Besimi si një mënyrë efektive edukimi dhe disiplinimi
- + Model i trashëguar i disiplinës nga brezi në brez
- + Mungesa e informacionit mbi efektet e dhunës tek fëmijët
- + Reagime të dhunshme ndaj faktorëve stresues
- + Mungesa e vetëkontrollit
- + Niveli i lartë i pranimi të dhunës në shoqëri

PASOJAT NEGATIVE TË NDËSHKIMIT TRUPOR TEK FËMIJËT

Ekspozimi ndaj dhunës gjatë fëmijërisë ka pasoja negative në zhvillimin psikologjik, fizik dhe emocional të fëmijës. Ndëshkimi trupor shkakton:

- **Dëmtimet fizike** të menjëhershme si: dhembje, plagosje të caktuara , mavijosje, gjakosje.
- Çrregullime në **funksionimin emocional dhe psikik** të fëmijës si për shembull: kultivimin e frikës, ndrojtjes, zhvillimin e ndjenjave të fajit, turpit, inferioritetit, pakënaqësisë, nervozizmit, vetmisë, humbja e besimit tek të rriturit dhe humbja e besimit në vetvete.
- **Probleme të zhvillimit të fëmijës** vijnë si rezultat i përdorimit të ndëshkimit trupor në fëmijërinë e tyre duke sjellë pasoja të tilla si: dëmtim të kujtesës, të vëmendjes, vështirësi komunikimi me moshatarët, kufizim i aftësisë për tu shoqëruar me të tjerët, si dhe aftësisë për pavarësi dhe iniciativë.
- **Përvetësimin e sjelljes së dhunshme** duke shkaktuar sjellje antisociale apo dhe delinkuente. Fëmijët mund të shfaqin edhe dëshira për të dëmtuar veten, si një formë vetë-ndëshkimi. Ata hakmerren për ndëshkimet që iu bëhen dhe mund të kundërpërgjigjen duke shkuar deri në mohimin apo refuzimine prindërve të tyre. Sa më shumë të zgjasë abuzimi, aq më serioze do të bëhen dëmtimet tek fëmija dhe akoma më e vështirë do të bëhet eliminimi i sjelljes abuzive.

POR ...A DUHEN DISIPLINUAR FËMIJËT ?

Sigurisht që po.....Por të disiplinosh do të thotë **të mësosh** dhe **jo të ndëshkosh**

Disiplina Pozitive është :

- Jo e dhunshme
- E përqëndruar në zgjidhje
- E mbështetur në respekt
- E bazuar në parimet e zhvillimit të fëmijës

SI TA ZBATOJMË DISIPLINËN POZITIVE ?

- TË KUPTOJMË ARSYEN PËRTEJ SJELLJES

Eshtë detyra jonë si prindër që të kuptojmë se pse po e bën fëmija një sjellje të pavend. Sapo të kuptojmë arsyen e vërtetë që fshihet pas kësaj sjellje, mund të kontrollojmë edhe pasojat.

- TË ORIENTOJMË SJELLJEN E FËMIJËVE.

Ti japim vëmendje sjelljes së pëlqyeshme dhe jo asaj negative. Fëmijët duhet të rriten duke kuptuar dallimin mes të mirës dhe të keqes.

- TË MOS “KORRUPTOJME”

Është e gabuar që ti ofrojmë fëmijëve dhurata si shpërblim kur ata sillen mirë. Kjo i bën ata të mendojnë që gjithmonë duhet të paguhen kur bëjnë sjellje të mira.

SI TË SHKOJMË DREJT NJË PRINDËRIMI POZITIV...???

JA DISA ASPEKTE TË CILAT COJNË DREJT NJË PRINDËRIMI POZITIV :

A. *Parandalimi i sjelljes së gabuar.*

- Ti duam fëmijët pavarësisht se çfarë bëjnë
- Nuk është e nevojshme të korigjojmë cdo gabim që ata bëjnë
- Të shpenzojmë kohë së bashku
- Të kërkojmë ndihmën e tyre për të zgjidhur problemet
- Të bëhemi modele positive
- Ti japim atyre siguri dhe ti dëgjojmë çfarë thonë
- Ti trajtojmë fëmijët me ëmbëlsi dhe dashuri
- Të argëtohem së bashku

B. *Menaxhimi i konfliktit dhe mësimi i përgjegjësive*

- Të vendosim rregulla dhe të shpjegojmë çfarë ndodh nëse ato shkelen
- Të përdorim **duhet** në vend të **nuk** duhet
- Të kërkojmë ndihmën e fëmijëve për të zgjidhur problemet
- Të fokusohemi në gjërat pozitive
- Të jemi të qëndrueshëm dhe të dimë të themi jo kur e ndjejmë të nevojshme
- Ti llogojmë ata nga situatat që nuk mund ti manovrojnë
- Të japim një paralajmërim dhe të rikujtojmë rregullat
- Të përdorim grafikë për të ndjekur ecurinë e sjelljes së mirë
- Të kërkojmë ndihmë kur gjendemi në vështirësi

C. *Përballja dhe korrektimi i sjelljes së gabuar*

- T'iu lëmë fëmijëve të përballen me pasojat e veprimeve të tyre, në mënyrë të sigurt
- T'iu heqim atyre privilegjet që gëzojnë kur nuk sillen mire, dhe ti japim vlerë sjelljes positive
- T'iu ndalojmë daljen nga shtëpia për të takuar shokët/shoqet
- T'iu kërkojmë të ndreqin dëmet e shkaktuara ose të paguajnë për to (me kusimet vetjake)
- T'iu bëjmë një qortim të vendosur mbi sjelljen negative
- T'iu detyrojmë të kalojnë një kohë të caktuar vetëm për të reflektuar mbi sjelljen e tyre

The Parenting Pyramid



